



KUVENDI I KOMUNËS

Ekstrakt

nga procesverbali i mbledhjes inauguruese të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mbajtur më 20 dhjetor 2017.

Mbledhja filloi në orën 10;00 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z.Mehmet Gashi, anëtar më i moshuar, i zgjedhur dhe certifikuar nga Komisioni Qendrorë i Zgjedhjeve - KQZ.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë anëtarët/et e zgjedhur dhe certifikuar këshilltarë/e të Kuvendit të Komunës së Podujevës sipas Vendimit të KQZ-së nr.2382/2017 të datës 29.11.2017, dhe Vendimit nr.2495/2017, përveç znj.Donjeta Jakupi e cila me arsye të paralajmëruar mungoi. Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Gjithashtu në mbledhje të pranishëm ishte z.Agim Veliu Kryetar i zgjedhur i Komunës së Podujevës dhe i certifikuar nga Komisioni Qendrorë i Zgjedhjeve, me Vendimin nr.2482/2017 të datës 07.12.2017.

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe z.Bekim Jashari, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame në Podujevë, z.Bekim Bislimi, Komandant i Stacionit të Policisë në Podujevë, z.Fidan Rekalii, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, përfaqësues të institucioneve të Komunës, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues nga Organizata të ndryshme Joqeveritare, përfaqësues të Komuniteteve, disa përfaqësues të mjeteve të informimit, dhe një numër i konsideruar i qytetarëve.

Fillimisht u bë intonimi i Himnit Shtetëror.

1. Hapja dhe kryesimi i mbledhjes nga këshilltari më i vjetër i Kuvendit

z.Mehmet Gashi, Kryesues i mbledhjes, theksoi, Zotëri Kryetar i Komunës, këshilltarë të zgjedhur, mysafirë të nderuar, zonja dhe zotërinj, mirë se keni ardhur në mbledhjen inauguruese të Kuvendit të Komunës. ju njoftoj se sipas të dhënave të cilat i posedon zyra për punë të Kuvendit, unë Mehmet Gashi, i lindur më 11 mars 1954, jam këshilltari më i moshuar në përbërjen e certifikuar në bazë të zgjedhjeve lokale të mbajtura më 22 tetor 2017.

Duke u bazuar se rregullat e kërkojnë që të verifikohet mosha e këshilltarit më të vjetër për të kryesuar me këtë mbledhje, ju pyeti se a ka ndonjë këshilltar më i moshuar se unë.

Ju lutem lajmërohuni nëse ka ndonjë këshilltar më i moshuar.

Meqenëse askush nuk po lajmërohet, konstatoj se pa vërejtje u verifikua këshilltari më i moshuar i Kuvendit.

Zotëri Kryetar i Komunës, këshilltarë të Kuvendit, mysafirë të nderuar, zonja dhe zotërinj, bazuar në nenin 42.5 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 4.6 të Udhëzimit Administrativ të MAPL-së nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenin 36.5 të Statutit të

Komunës së Podujevës, dhe në bazë të Rregullores së Punës të Kuvendit të Komunës, e hapi mbledhjen inauguruese të Kuvendit të Komunës së Podujevës.

Para se të vazhdojmë me punë, ju informoj se në bazë të listës së nënshkruar, të pranishëm në këtë mbledhje janë 34 (tridhjetekatër) anëtarë/e të Kuvendit të Komunës të cilët janë të certifikuar nga Komisioni Qendrorë i Zgjedhjeve - KQZ me Vendimin nr.2382/2017 të datës 29.11.2017 si dhe Vendimi i KQZ-së nr.2495/2017 i datës 07.12.2017 sipas të cilit z.Patriot Rudari nga radhët e subjektit politik AAK është emëruar anëtarë i Kuvendit të Komunës duke zëvendësuar z.Fatmir Humollin i cili ka dhënë dorëheqje të parevokueshme nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës së Podujevës.

Ndërsa, mungon me arsye, zonja Donjeta Jakupi, mungesë të cilën e ka paralajmëruar.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës

2. Ngritja e Komisionit të përkohshëm për verifikimin e mandatit të këshilltarëve të Kuvendit

Lidhur me këtë çështje me legjislacionin në fuqi parashihet ngritja e një Komisioni për verifikimin e mandateve të anëtarëve të Kuvendit të Komunës. Deri më tani është praktikuar që Komisioni të ngritet prej 3 anëtarëve nga subjektet politike me numrin më të madh të anëtarëve që përfaqësohen në këtë Kuvend, andaj propozoj të vazhdohet njëjtë. Ju lutem a pajtoheni me këtë propozim që komisioni në fjalë të përbëhet prej 3 anëtarëve.

U konstatua se njëzëri u mbështet propozimi për ngritjen e Komisionit të përkohshëm për verifikimin e mandatit të këshilltarëve të Kuvendit, në përbërje prej 3 anëtarëve, përkatësisht nga 1(një) anëtar prej subjekteve politike me numrin më të madh të anëtarëve që përfaqësohen në këtë Kuvend.

Kryesuesi i mbledhjes, ftoj përfaqësuesit e subjekteve sipas radhës të bëjnë propozimet e tyre:

Lidhja Demokratike e Kosovës

Lëvizja Vetëvendosje, dhe

Partia Demokratike e Kosovës

z.Fatmir Gashi, fillimisht përshëndeti të pranishmit, theksoi, në emër të subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, për anëtar në Komisionin e cekur, propozoj z.Avni Fetahun.

z.Bajram Ajeti, theksoi, në emër të Grupit të asamblistëve të Vetëvendosjes, unë propozoj znj.Doruntina Hasanin, për anëtare në Komisionin në fjalë.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, në emër të Grupit të anëtarëve të Kuvendit nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës, për anëtar në këtë Komision, propozoj z.Fatmir Rudarin.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i mbledhjes, theksoi, falënderoj përfaqësuesit paraprak të subjekteve përkatëse politike për propozimet e dhëna.

Tani mund të votojmë për ngritjen e komisionit, Ju lutem me ngritje dore deklarohuni se a pajtoheni me propozimet e paraqitura.

Pas votimit u konstatohet se njëzëri u ngrit Komisioni i përkohshëm për verifikimin e mandatit të këshilltarëve të Kuvendit, në këtë përbërje:

- 1- Avni Fetahu, nga radhët e subjektit Lidhja Demokratike e Kosovës
- 2- Doruntina Hasani, nga radhët e subjektit Lëvizja Vetëvendosje
- 3- Fatmir Rudari, nga radhët e subjektit Partia Demokratike e Kosovës

Kryesuesi i mbledhjes, në vazhdim theksoi, kërkoj nga Komisioni që të dalë këtu tek zyrtari për punë të Kuvendit dhe të bëjë verifikimin e mandatit të anëtarëve, sipas dokumentacionit përkatës të KQZ-së për zgjedhjet lokale të 22 tetorit 2017.

Pas përfundimit të verifikimit, ftoj përfaqësuesin e Komisionit të paraqet raport.

➤ **Raporti i Komisionit për verifikimin e mandatit të këshilltarëve të Kuvendit**

z.Avni Fetahu, në emër të komisionit, raportoj se ne si Komision për verifikimin e mandatit të anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Podujevës, bazuar në dokumentacionin e Komisionit Qendrorë të Zgjedhjeve – KQZ, Vendimi nr.2382/2017 të datë 29 nëntor 2017 për certifikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve për Kuvendin Komunal dhe Listën e bashkëngjitur në atë Vendim, si dhe duke u mbështetur Vendimin e KQZ-së nr.2495/2017 i datës 07.12.2017 për zëvendësimin – emërimin e një anëtari të Kuvendit, konstatuam se anëtarët prezent të Kuvendit të Komunës së Podujevës, janë në përputhje me dokumentacionin e lartcekur.

Përndryshe nëse e shihni të arsyeshme t'i lexojmë emër për emër anëtarët e Kuvendit sipas listës së certifikuar nga KQZ, mund ta bëjmë një gjë të tillë.

U konstatua edhe mungesa e paralajmëruar, me arsye, e anëtares së zgjedhur dhe certifikuar znj.Donjeta Jakupi.

Kryesuesi i mbledhjes, theksoj, pas raportit të Komisionit, mund të vazhdojmë me punë në pikën vijuese

3. Dhënia e Betimit nga këshilltarët e Kuvendit

z.Mehmet Gashi, Kryesuesi i mbledhjes, theksoi, të nderuar anëtare anëtarë të Kuvendit, ju përkujtoj se Betimi solemn i bëhet bashkërisht, unë e lexojë pjesë pjesë tekstin e betimit i cili përsëritet në mënyrë të zëshme nga Ju këshilltarët, me të vetmin ndryshim që pas fjalës, UNË, secili këshilltarë/e e thotë emrin dhe mbiemrin e vet.

Në vazhdim zyrtarët për punë të Kuvendit do ju a shpërndajnë deklaratat e betimit të cilat pas dhënies së betimit, i nënshkruani dhe të njëjtat u dorëzohen të vulosura në përfundim të mbledhjes. Pasi bëhet shpërndarja e deklaratës së betimit të gjithë anëtareve dhe anëtarëve të Kuvendit, Kryesuesi i mbledhjes fton anëtarët dhe anëtarët e Kuvendit të ngritën në këmbë për dhënien e Betimit.

Me tekstin si në vijim,

Unë, _____ betohem se do t'i kryejë me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtrojë autorizimet e mia si këshilltar i Kuvendit të Komunës së Podujevës, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë.

Betimin e dhanë:

Fatmir Gashi.....anëtar nga radhët e subjektit politik LDK
Avni Fetahu.....anëtar nga radhët e subjektit politik LDK
Mirsad Kamerolli.....anëtar nga radhët e subjektit politik LDK
Agron Hyseni.....anëtar nga radhët e subjektit politik LDK
Faik Muçiqi.....anëtar nga radhët e subjektit politik LDK
Agim Behluli.....anëtar nga radhët e subjektit politik LDK
Liridona Shabani.....anëtare nga radhët e subjektit politik LDK
Hasan Ajeti.....anëtar nga radhët e subjektit politik LDK
Adnan Zymeri.....anëtar nga radhët e subjektit politik LDK
Mrika Thaqi.....anëtare nga radhët e subjektit politik LDK
Mehmet Gashi.....anëtar nga radhët e subjektit politik LDK
Qëndrim Softolli.....anëtar nga radhët e subjektit politik LDK
Arlinda Kadriu.....anëtare nga radhët e subjektit politik LDK
Valbone Kadriu – Podvorica.....anëtare nga radhët e subjektit politik LDK
Fatlume Jaha.....anëtare nga radhët e subjektit politik LDK
Bajram Ajeti.....anëtar nga radhët e subjektit politik LVV
Florent Hasani.....anëtar nga radhët e subjektit politik LVV
Blerim Maçastena.....anëtar nga radhët e subjektit politik LVV
Fitim Haziri.....anëtar nga radhët e subjektit politik LVV
Vendenis Lahu.....anëtar nga radhët e subjektit politik LVV
Fitim Muçolli.....anëtar nga radhët e subjektit politik LVV
Lirika Maliqi.....anëtare nga radhët e subjektit politik LVV
Adelinë Stublla.....anëtare nga radhët e subjektit politik LVV
Doruntina Hasani.....anëtare nga radhët e subjektit politik LVV
Rafet Llapashtica.....anëtar nga radhët e subjektit politik PDK
Bashkim Syla.....anëtar nga radhët e subjektit politik PDK
Endritë Murati.....anëtare nga radhët e subjektit politik PDK
Arbër Blaku.....anëtar nga radhët e subjektit politik PDK
Floretë Zejnullahu.....anëtare nga radhët e subjektit politik PDK
Fatmir Rudari.....anëtar nga radhët e subjektit politik PDK
Patriot Rudari.....anëtar nga radhët e subjektit politik AAK
Tringa Sfishta.....anëtare nga radhët e subjektit politik AAK
Avni Islami.....anëtar nga radhët e subjektit politik OBKD
Esat Ejupi.....anëtar nga radhët e subjektit politik PD

Pas dhënies së Betimit, anëtares dhe anëtarët e Kuvendit e nënshkruan Deklaratën e betimit.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i mbledhjes, nënvizoi, tani edhe zyrtarisht jemi anëtarë/e të Kuvendit të Komunës së Podujevës, urime suksese dhe punë të mbarë.

4. Dhënia e Betimit nga Kryetari i Komunës

z.Mehmet Gashi, Kryesues i mbledhjes, theksoi, tani e ftoj zotëriun Agim Veliu, Kryetar Komunës së Podujevës, të jap Betimin solemn, urdhëroni zotëri Kryetar.

Me tekstin si në vijim,

Unë, AGIM NUHI VELIU, betohem që do t'i kryejë detyrat dhe do t'i ushtroj kompetencat si Kryetar i Komunës së Podujevës, me nder, besnikëri, në mënyrë të paanshme, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që t'i siguroj kushtet për jetë të qetë për të gjithë.

Kryetari i Komunës z.Agim Veliu e japi Betimin dhe e nënshkroi Deklaratën e betimit.

z.Mehmet Gashi, Kryesuesi i mbledhjes, theksoi, urime zotëri Kryetar, ju dëshiroj punë të mbarë dhe suksese.

Kalojmë në pikën e radhës dhe ftoi Kryetarin e Komunës të paraqet fjalën e rastit.

5. Fjala e rastit e z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës

z.Agim Veliu, Kryetar i Komunës, theksoi, të dashur qytetarë, të respektuar këshilltarë komunalë, i nderuar kryesues, përfaqësues nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të KFOR-it dhe OSBE-së, i nderuar kryetar i Këshillit të Bashkësisë Islame, Komandantë i Stacionit të Policisë në Podujevë, përfaqësues të Shoqërisë civile, të nderuar përfaqësues të mediave dhe ju pjesëmarrës të tjerë të nderuar,

Në këtë ditë solemne të betimit, që shënon fundin e një mandati të suksesshëm dhe fillimin e një mandati të ri në shërbim të qytetarëve edhe për katër vitet e ardhshme, ju ftoj që këtë detyrë fisnike, por edhe sfiduese, ta bëjmë mandat për qytetarët, nevojat dhe kërkesat e tyre.

Nuk ka më mirë se të jesh në gjendje për të punuar së bashku me qytetarët llapjanë në ndërtimin e qytetit dhe fshatrave tona, por edhe në ndërtimin e një vizioni të përbashkët se si duam ta shohim të ardhmen tonë.

Zgjedhjet ishin të lodhshme dhe më vjen mirë që morën fund pa asnjë incident, sidomos me një rezultat me diferencë kogja të ndjeshme votash në favorin e programit tim qeverisës, e që nuk u kontestua nga askush.

Pavarësisht se qytetarët llapjanë me votën e tyre ma besuan përgjegjësinë që edhe një mandat qeverisës të jem në krye të Komunës, nuk dua që sot askush në këtë sallë, apo ata qytetarë në shtëpitë e tyre, që në zgjedhje nuk më votuan, të ndjehen humbës.

Përkundrazi, në këtë garë nuk ka fitues dhe humbës, por ka vetëm një vendim demokratik se kë duan qytetarët llapjanë t'u shërbejë në katër vitet e ardhshme.

Nga kjo foltore e Kuvendit ju them të gjithëve, se do të jem në shërbimin tuaj, pa dallim partie, fshati apo lagjeje. Llapi vërtetë është i madh, por jo aq i madh sa ta ndajmë në fshatra e lagje, parti apo ego personale. Podujeva ka nevojë për të gjithë neve, dhe këtu në këtë sallë, po e theksoj, se do të punoj për Podujevën si tanësi.

Ju drejtohem në veçanti juve këshilltarëve, të të gjitha partive politike. Ejani të diskutojmë, ejani te unë në zyrë, siç do të vij edhe unë tek ju, për t'ua shtrirë dorën e bashkëpunimit, për projektet dhe idetë tuaja, në funksion të zhvillimit të qytetit.

Unë kam programin tim, por jam i sigurt se edhe ju në programet tuaja keni projekte të mira për qytetin dhe qytetarët pa dallim, prandaj, ju ftoj, duke ju kërkuar njëkohësisht të bëni opozitën e fuqishme, të bashkëpunojmë e jo të grindemi. Të diskutojmë me argumente dhe fakte, në të mirë ose në kundërshtim të një ideje.

Ju siguroj, se ne do t'u shërbejmë më shumë interesave të qytetarëve nëse bashkëpunojmë, sesa nëse mbajmë inate dhe grindemi.

Sivjet ne kemi miratuar buxhetin e Komunës për vitin 2018, por jam i sigurt që në rishikimin e parë, të gjithë ju, shefa të grupeve politike dhe kuvendarë, do të propozoni projekte të reja, të bazuara në nevojat dhe kërkesat e arsyeshme të qytetarëve tanë.

Këtu po shoh shumë fytyra të reja, që do të thotë përfaqësues të rinj të qytetarëve, dhe duke qenë kështu, jam i sigurt se do të ketë ide të reja se si mund t'i qasemi zgjidhjes së problemeve që mund të paraqiten.

Ne kemi një buxhet modest, të pamjaftueshëm, por do t'i zgjidhim të gjitha nevojat e qytetarëve. Është e vërtetë, buxheti ka ardhur duke u rritur, por janë rritur edhe nevojat e qytetarëve. Qyteti po rritet, fshatrat po zhvillohen, prandaj, po rriten edhe nevojat e standardit të ri jetësor.

Pra, në mënyrë që ta shpenzojmë mençur e me nikoqirllëk buxhetin tonë të pamjaftueshëm, ne duhet të dalim me projektet më të mira, më të nevojshme për momentin, dhe me një kosto më efektive. Po punuam së bashku, ne do të jemi në gjendje t'i identifikojmë shumë projekte të tilla të cilat do ta përmirësonin jetën e qytetarëve.

Në zgjedhje, vërtetë garuam me siglat tona partiake, por këtu jemi përfaqësues të qytetarëve para së gjithash. Këtu na ka sjellë qytetari. Partia na ka nominuar, por Ju, dhe unë, jemi këtu, sepse kështu ka zgjedhur qytetari.

Prandaj, ju ftoj që në këtë tempull të demokracisë, të diskutojmë e të mendojmë për problemet e qytetarëve si përfaqësues legjitim të tyre, dhe unë Ju siguroj se pari do të bëj këtë vet.

Tani, në fund, duke ju falënderuar për bashkëpunim e bashkërendim paraprak, ju them se do të vazhdoj të jem në shërbimin e të gjithë qytetarëve pa dallim.

Zoti e bekoftë punën tonë të mbarë

Zoti e bekoftë Podujevën dhe qytetarët e saj

Zoti e bekoftë Kosovën.

Ju faleminderit!

z.Mehmet Gashi, Kryesues i mbledhjes, theksoi, para se të përfundojmë me këtë mbledhje, kam një njoftim për këshilltarët e Kuvendit të Komunës të cilët në afatin sa më të shkurtër, nga secili, duhet të sjellën, fotokopja e letërnjoftimit, dhe konfirmimi i llogarisë bankare. Dokumentet e cekura të dorëzohen në Komunë, përkatësisht në zyrën ligjore, zyra nr.24.

Gjithashtu, ju njoftoj se në cilësinë e këshilltarit të Kuvendit të Komunës, jemi të obliguar që në afatin prej 30 ditësh të plotësojmë dhe dorëzojmë në Agjensionin Kundër Korrupsion, formularin e deklarimit të pasurisë, sa jam i informuar, kjo vlen për anëtarët dhe anëtarët e rinj të Kuvendit gjegjësisht për ata të cilët nuk kanë qenë mandatin e kaluar, ndërsa për ata të cilët janë ri zgjedhur vlen deklarimi i rregullt i pasurisë.

Pra ky është një obligim ligjor për të gjithë ne, mirëpo për çdo sqarim shtesë, mund të drejtoheni në zyrën nr.15, tek zyrtari përkatës, Ragip Jaholli.

Me kaq, e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje, mirë u pafshim në mbledhjet e ardhshme.

Mbledhja përfundoi në ora 10;25

Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli

Nr.01-060/04-91231/17
Podujevë,
20 dhjetor 2017

Kryesuesi i mbledhjes
Mehmet Gashi